

# UNIVERSITETI I SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI”



**GUIDË**  
PËR STUDENTËT  
E RINJ



## UNIVERSITETI I SHKODRËS

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" nisi veprimtarinë mësimore-pedagogjike dhe shkencore si Institut Pedagogjik 2-vjeçar, më 2 shtator të vitit 1957. Ky ishte institucioni i parë publik i arsimit të lartë që u hap në Veri të Shqipërisë. Ai u emërtua universitet me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 167, datë 28.05.1991. Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" ofron personel akademik të kualifikuar, programe të shumta studimi që u përgjigjen kërkesave të tregut të punës, laboratorë të pajisur me mjete teknologjike të kohës, bibliotekë shkencore me fond shumë të pasur, i cili pasurohet me literaturë bashkëkohore në gjuhë shqipe dhe në gjuhë të huaj. Universiteti i Shkodrës disponon edhe bibliotekë digjitale.



# FAKULTETET

## 1. FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS

- a) Departamenti i Biologji –Kimisë,
- b) Departamenti i Fizikës,
- c) Departamenti i Matematikë-Informatikës
- d) Departamenti i Lëndëve Paraklinike
- e) Departamenti i Lëndëve Klinike
- f) Qendra e Studimit të Ujërave të Rajonit të Shkodrës

## 2. FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

- a) Departamenti i Mësuesisë
- b) Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale
- c) Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve
- d) Departamenti i Arteve

## 3. FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE

- a) Departamenti i Gjuhësisë
- b) Departamenti i Letërsisë
- c) Departamenti i Historisë
- d) Departamenti i Gjeografisë
- e) Qendra e Studimeve Albanologjike

## 4. FAKULTETI I DREJTËSISË

- a) Departamenti i të Drejtës Publike
- b) Departamenti i të Drejtës Civile
- c) Departamenti i të Drejtës Ndërkombëtare dhe Evropiane

## 5. FAKULTETI EKONOMIK

- a) Departamenti i Administrim-Biznesit
- b) Departamenti i Financë-Kontabilitetit
- c) Departamenti i Turizmit

## 6. FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

- a) Departamenti i Gjuhës Angleze
- b) Departamenti i Gjermanistikës
- c) Departamenti i Romanistikës

Universiteti i Shkodrës  
është i licencuar me VKM  
Nr.150, datë 18.04.1957 si  
Instituti Pedagogjik 2-vjeçar i  
Shkodrës dhe VKM Nr.124,  
datë 28.05.1991 si  
Universiteti “Luigj  
Gurakuqi”

Universiteti i Shkodrës  
është akredituar  
me Vendim të  
ASCAL  
Nr 03,  
datë 24.01.2020

## Universiteti i Shkodrës ofron 73 programe studimi në tre ciklet e studimit:

1. Cikli i parë - Bachelor (30 programe studimi)
2. Cikli i dytë - Master i Shkencave (14 programe studimi) & Master Profesional (22 programe studimi)
3. Program i Integruar i Ciklit të Dytë Master i Shkencave (1 program studimi)
4. Cikli i tretë - Doktoratë (2 programe studimi)
5. Program studimi i Formimit të Vazhduar (1 program studimi)
6. 3 programe studimi me karakter profesional (120 ECTS dhe 60 ECTS)



# FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS

Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) si njësi kryesore e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” e nisi veprimtarinë e tij mësimore dhe shkencore me themelimin e Institutit të Lartë Pedagogjik, më 2 shtator 1957. FSHN ofron këto programe studimi në departamentet përkatëse:

## 1. DEPARTAMENTI I MATEMATIKËS:

- a) Bachelor në “Matematikë”
- b) Bachelor në “Informatikë”
- c) Master Profesional në “Matematikë me Profil Minor në Informatikë”
- d) Master Profesional në “Informatikë me Profil Minor në Matematikë”
- e) Program studimi me karakter profesional në “Teknik sistemesh dhe rrjetesh kompjuterike”
- f) Bachelor në “Informatikë” në gjuhën angleze
- g) Master Profesional në “Zhvillim programesh të avancuara”

## 2. DEPARTAMENTI I BIOLOGJI-KIMISË:

- a) Bachelor në “Biologji-Kimi”
- b) Master Profesional në “Biologji-Kimi”
- c) Master i Shkencave në “Biologji Mjedisore”
- d) Bachelor në “Biologji - Kimi” në gjuhën angleze
- e) Bachelor në “Shkencat e Ushqimit”

## 3. DEPARTAMENTI I FIZIKËS:

- a) Bachelor në Fizikë
- b) Master Profesional në Mësuesi në “Matematikë-Fizikë”
- c) Program studimi me karakter profesional “Specialist i Lartë Elektrik”

## 4. DEPARTAMENTI I LËNDËVE KLINIKE:

- a) Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme”

## 5. DEPARTAMENTI I LËNDËVE PARAKLINIKE:

- a) Bachelor në “Infermieri (Mami)”
- b) Bachelor në “Fizioterapi”
- c) Master Profesional në “Psikologji Shëndeti”

# FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

Fakulteti i Shkencave të Edukimit i ka filluar e tij në vitin akademik 1981 – 1982 me hapjen e programit të studimit për Mësues për klasat I – IV të shkollës 9- vjeçare (Cikli i Ulët). Po në këtë vit akademik u krijua katedra e Psikologjisë dhe Pedagogjisë. FSHE ofron këto programe studimi në departamentet përkatëse:

## 1. DEPARTAMENTI I MËSUESISË:

- a) Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”
- b) Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”
- c) Master Profesional në “Mësuesi për Arsim Fillor”
- d) Master i Shkencave në “Mësuesi në Biologji - Kimi me Profil Minor në Karriera dhe Aftësimi për Jetën”
- e) Master Profesional në “Pedagogji Speciale”
- f) Program studimi i Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike (35 ECTS)

## 2. DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË DHE PUNËS SOCIALE:

- a) Bachelor në “Psikologji”
- b) Bachelor në “Punë Sociale”
- c) Master i Shkencave në “Psikologji Klinike”
- d) Master i Shkencave në “Psikologji Organizative”
- e) Master Profesional në “Shërbimet Sociale”

## 3. DEPARTAMENTI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTEVE:

- a) Bachelor në “Edukim Fizik”
- b) Master Profesional në “Mësuesi në lëndët Edukim Fizik dhe Sporte”

## 4. DEPARTAMENTI I ARTEVE:

- a) Bachelor në “Pedagogji Muzikore”
- b) Bachelor në “Pikturë dhe Grafikë”
- c) Master Profesional në “Mësuesi i Artit Pamor”
- d) Master Profesional në “Mësuesi Muzike”



# FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE

Fakulteti i Shkencave Shoqërore është një prej themelvënësve të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" dhe e ka gjenezën e tij që në vitin 1957 kur u hap Instituti i Lartë Pedagogjik 2-vjeçar i Shkodrës. Pranë këtij fakulteti është ngritur dhe funksionon Qendra e Studimeve Albanologjike. Në vitin akademik 2011-2012 u hap shkolla doktrale "Gjuhë shqipe", në të cilën kryhen studime të thelluara në fushën e gjuhësisë. FSHSH-ja ofron këto programe studimi në departamentet përkatëse:

## DEPARTAMENTI I GJUHËSISË:

- a) Bachelor në "Gjuhë-Letërsi"
- b) Master i Shkencave në "Studime shqiptare dhe etnokulturore, profili "Studime të Thelluara në Gjuhësi"
- c) Cikli i tretë "Doktoratë" në "Gjuhë Shqipe"

## DEPARTAMENTI I LETËRSISË:

- a) Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"
- b) Master Profesional në "Mësuesi në Gjuhë-Letërsi"
- c) Master i Shkencave në "Studime shqiptare dhe etnokulturore, profili "Etnokultura dhe Letërsia Shqipe"

## DEPARTAMENTI I HISTORISË:

- a) Bachelor në "Histori"
- b) Bachelor në "Histori dhe trashëgimi kulturore"
- c) Master i Shkencave në "Studime të Historisë dhe të Kulturës Shqiptare"

## DEPARTAMENTI I GJEOGRAFISË:

- a) Bachelor në "Gjeografi"
- b) Master Profesional në "Mësuesi Histori dhe Gjeografi"
- c) Master i Shkencave "Studime Regjonale në Gjeografi"
- d) Program studimi me karakter profesional në "Udhërrëfyes Turistik dhe Mënaxhues i Itinerareve Turistike për Rajonin Verior"
- e) Bachelor në "Gjeografi dhe Zhvillim Territori"

# FAKULTETI I DREJTËSISË

Fakulteti i Drejtësisë është themeluar në vitin 1992 me programin e studimit 4 vjeçar në Drejtësi. Me VKM nr. 349, datë 10.08.1992 u kalua në programin e studimit 3 vjeçar Bachelor në Drejtësi. Në vitin akademik 2020-2021 u aplikua për herë të parë programi i integruar i studimeve të ciklit të dytë 5-vjeçar. Fakulteti i Drejtësisë ofron këto programe studimi:

1. Program i Integruar i studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Drejtësi” (300 ETCS)
2. Master i Shkencave në “E Drejta Kushtetuese dhe Administrative”
3. Master i Shkencave në “E Drejta Private dhe e Biznesit”





# FAKULTETI EKONOMIK

Fakulteti Ekonomik është themeluar në vitin 1993, me Vendimin nr. 349, datë 10.8.1992 të MASH, mbi bazën e shkollës amerikane të biznesit dhe mbështetjen e Universitetit të Ilinoisit të Jugut, Carbondale dhe Universitetit të Nebraskës në SHBA. FE ofron këto programe studimi në departamentet përkatëse:

## 1. DEPARTAMENTI I ADMINISTRIM- BIZNESIT:

- a) Bachelor në " Administrim-Biznes"
- b) Master Profesional në " Administrim Biznes"
- c) Master i Shkencave në " Administrim Biznesi"

## 2. DEPARTAMENTI I TURIZMIT:

- a) Bachelor në "Turizëm"
- b) Master i Shkencave në "Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm"
- c) Master Profesional në " Trashëgimi Kulturore dhe Manaxhim Turizmi"
- d) Cikli i tretë "Doktoratë" në "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm"

## 3. DEPARTAMENTI I FINANCË- KONTABILITET:

- a) Bachelor në " Financë - Kontabilitet"
- b) Master i Shkencave në " Kontabilitet"
- c) Master i Shkencave në "Financë"
- d) Master Profesional në " Financë-Bankë"
- e) Master Profesional në " Menaxhimi Financiar, Kontabiliteti dhe Kontrolli në Administratën Publike"



# FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja është krijuar si njësi qendrore më vete në vitin 2001, me Vendimin MASH, dt. 31.01.2001, mbi bazën e Departamentit të Gjuhëve të Huaja dhe Departamentit të Gjermanistikës. FGJH-ja ofron këto programe studimi në departamentet përkatëse:

## 1. DEPARTAMENTI I ROMANISTIKËS:

- a) Bachelor në "Gjuhë Italiane"
- b) Bachelor në "Gjuhë Frënge"
- c) Master në "Mësuesi në Gjuhë Italiane"
- d) Master në "Mësuesi në Gjuhë Frënge"

## 2. DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE:

- a) Bachelor në "Gjuhë Angleze"
- b) Master në "Mësuesi në Gjuhë Angleze"

## 3. DEPARTAMENTI I GJERMANISTIKËS:

- a) Bachelor në "Gjuhë Gjermane"
- b) Master në "Mësuesi në Gjuhë Gjermane"



# NDËRKOMBËTARIZIMI DHE MUNDËSITË E STUDIMIT NË UNIVERSTETET E HUAJA

- Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” është partner në programe të Bashkimit Evropian si Erasmus +, Credit Mobility KA107, IPACross Border, CEEPUS etj.
- Gjatë viteve të fundit, mbi 100 studentë kanë ndjekur studimet për një semestër (6 muaj) në universitete të huaja në kuadër të Erasmus +, Credit Mobility në universitetet partnere në shtete të ndryshme, si: Itali, Gjermani, Letoni, Austri, Kroaci, Çeki, Bullgari, Spanjë, Poloni, Portugali. Të gjitha shpenzimet për këto shkëmbime janë mbuluar nga fondet e Bashkimit Evropian.



## KUJDESI PËR STUDENTËT ME NEVOJA TË VEÇANTA

- Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” respekton të drejtat e personave me nevoja të veçanta. Atyre u krijohen mundësi të përshtatshme për mësimdhënie e mësim-nxënie, si dhe mjedise të favorshme, të cilat janë në përmirësim të vazhdueshëm.
- Në funksion të studentëve me nevoja të veçanta është edhe “Laboratori Gjithëpërfshirës” që gjendet pranë Bibliotekës Shkencore të Universitetit “Luigj Gurakuqi ([lgj@unishk.edu.al](mailto:lgj@unishk.edu.al)).



## BIBLIOTEKA SHKENCORE E UNIVERSITETIT "LUIGJ GURAKUQI"

- Biblioteka Shkencore e Universitetit "Luigj Gurakuqi" ka filluar veprimtarinë e saj që me krijimin e Institutit Pedagogjik Shkodër në vitin 1957.
- Kjo bibliotekë ka një fond prej rreth 150 mijë njësi bibliotekare (libra, gazeta, kaseta, CD dhe DVD) në shqip dhe gjuhë të huaj në shërbim të studentëve, stafit të fakulteteve të Universitetit "Luigj Gurakuqi" si dhe komunitetit.
- Biblioteka ofron për përdoruesit e saj një sërë shërbimesh e ambientesh, si: informacion dhe huazim, mediatekë me 26 vende multimediale, tri salla leximi me 300 vende. Salla e konferencave "Walter Hoeflechner" ka një kapacitet me 120 vende. Kjo sallë mundëson zhvillimin e një sërë aktiviteteve me karakter akademik, shkencor e promovues.
- Biblioteka Shkencore e Universitetit "Luigj Gurakuqi" ofron një shërbim bashkëkohor edhe në formë elektronike përmes adresave që gjenden në faqen zyrtare ([www.bush.unishk.edu.al](http://www.bush.unishk.edu.al)).



## PALESTRA E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI”

- Palestra e universitetit është një hapësirë që u ofrohet studentëve jo vetëm në funksion të procesit mësimor, por edhe si mjedis ku organizohen aktivitete argëtuese e sportive. Ajo është e pajisur me logjistikën e nevojshme.
- Në këtë palestër zhvillon aktivitetet edhe Shoqata Sportive e Universitetit “Luigj Gurakuqi”.









## UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI"

Adresa: Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Rektorati, Sheshi 2 Prilli, Shkodër, Albania P.O.BOX 4001

Kontakt: Email-info@unishk.edu.al

Website: www.unishk.edu.al



Universiteti.luigj.gurakuqi



Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

